

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi Parashtrues: Mbrojtësi i Specializuar i Hysni Gucatit

Data: 16 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidenciale

Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris QC

Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Bastian Martens

I. HISTORIKU

1. Me urdhrin e datës 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake informoi z. Gucati dhe të dyshuarin tjetër në këtë çështje gjyqësore, z. Haradinaj, ("të dyshuarit"), se ZPS-ja ka paraqitur aktakuzë ("Aktakuza") rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* kundër tyre¹.
2. Kjo u bë pasi ZPS-ja deklaroi publikisht në seancën e 1 tetorit 2020 synimin e saj për të paraqitur aktakuzë kundër të dyshuarve deri në fund të tetorit 2020².
3. Në paragrafin 10 të të njëjtit urdhër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vuri në dukje se³:
 - (a) Z. Gucati tashmë është arrestuar dhe vazhdon të mbahet në paraburgim;
 - (b) Sidoqoftë, z. Gucati nuk është njoftuar për akuzat konkrete që i janë bërë në aktakuzë; dhe se
 - (c) Z. Gucati ka të drejtë të ketë të gjithë informacionin e domosdoshëm për të qenë të gjendje të sigurojë rishikim efektiv të paraburgimit të tij.
4. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake deklaroi se⁴:

¹ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës*, 11 nëntor 2020, konfidencial, para. 5.

² KSC-BC-2020-07, transkript i seancës, 1 tetor 2020, publik, f. 15

³ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës*, 11 nëntor 2020, konfidencial, para. 10.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës*, 11 nëntor 2020, konfidencial, para. 11.

“...[ai është] i prirë që, në rrethana të veçanta të çështjes konkrete, ta bëjë Aktakuzën të disponueshme për të dyshuarit, me redaktimet e nevojshme. Më tej, nëse dëshirojnë, për hir të drejtësisë, ata mund të bëjnë gjithashtu parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Kjo nuk e paragjykon ushtrimin e të drejtave nga të Dyshuarit sipas Ligjit dhe Rregullores.”

5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ftoi palët të bëjnë parashtrime në lidhje me këtë çështje deri më 17 nëntor 2020.

II. PARASHTRIM MBI PROCEDURËN E RISHIKIMIT TË AKTAKUZËS

6. Për arsyet e përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në paragrafët 10 dhe 11 të urdhrit të datës 11 nëntor 2020, dhe pa paragjykuar ushtrimin e të drejtave të z. Guçati sipas Ligjit dhe Rregullores, parashtrime që (i) Aktakuza me Anekset 1-3⁵, t'i bëhet e disponueshme Mbrojtjes, ashtu siç synon të urdhërojë Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dhe (ii) pas kësaj, Mbrojtja të lejohet të bëjë parashtrime për Aktakuzën gjatë rishikimit të saj, përsëri ashtu siç synon të urdhërojë Gjykatësi i Procedurës Paraprake.
7. Në lidhje me redaktimet, parashtrime se ZPS-ja duhet të identifikojë kategorinë e çdo redaktimi të propozuar dhe arsyen pse konsiderohet i domosdoshëm, duke i dhënë mundësi Mbrojtjes që të përgjigjet në vijim.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesa në lidhje me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

Numri i fjalëve në original: 483

/nënshkrimi/

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtësi i Specializuar i Hysni Gucatit

Hju Bauden

Bashkëmbrojtësi i Specializuar i Hysni Gucatit

16 nëntor 2020

Kardif, Britani e Madhe